

VENDIM
Nr.235, datë 6.3.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.84, DATË 3.2.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR “KALIMASH-MORINË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.84, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

a) Sipërfaqes së tokës/truall, 18 092 (tetëmbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) m², i shtohet sipërfaqja 1 238 (një mijë e dyqind e tridhjetë e tetë) m².

b) Vlerës së tokës/truall, 47 647 100 (dyzet e shtatë milionë e gjashtëqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind) lekë, i shtohet vlera 6 820 142 (gjashtë milionë e tetëqind e njëzet mijë e njëqind e dyzet e dy) lekë.

c) Vlerës së objekteve, 110 977 628.7 (njëqind e dhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë pikë shtatë) lekë, i shtohet edhe vlera 15 555 968 (pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

ç) Vlerës së përgjithshme të shpronësimit, prej 320 103 926.7 (treqind e njëzet milionë e njëqind e tre mijë e nëntëqind e njëzet e gjashtë pikë shtatë) lekësh, i shtohet edhe vlera 22 376 110 (njëzet e dy milionë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dhjetë) lekë.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shpronësimi shtesë të fillojë më 10.3.2009 dhe të përfundojë më 10.5.2009.

4. Pronarët, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim ZRPP”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Pronarët e objekteve, përveç dokumentacionit të pronësisë, duhet të paraqesin edhe dokumentacionin tekniko-ligjor.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

Për objektet, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve në bazë të dokumentacionit ligjor të pronësisë dhe në bazë të dokumentacionit tekniko-ligjor.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 Qarku: Kukës
 Bashkia: Kukës
 Qyteti: Kukës

LISTA E PRONARËVE QË PREKEKN NGA KORRIDORI DURRËS-MORINË (SEKSIONI KALIMASH-MORINË)
 Lloji i pasurisë së patundshme: truall dhe objekt

Nr.	Pronari			ZK	Nr. pas.	Tokë truall			Objekt, vlera lekë	Vlera totale, lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi m ²	Vlera lekë			
1	Zaim	Veli	Cenaj	2315	41/27	139	5509	765751	4295400	5061151	Konfirmuar nga ZRPP
2	Tasim	Ahmet	Cenaj	2315	41/26	500	5509	2754500	2612734	5367234	Konfirmuar nga ZRPP
3	Haxhi	Nuhi	Cenaj	2315	41/25	358	5509	1972222	5358736	7330958	Konfirmuar nga ZRPP
4	Isuf	Sali	Cenaj	2315	41/11	241	5509	1327669	3289098	4616767	Konfirmuar nga ZRPP
	TOTALI					1238		6820142	15555968	22376110	

